



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVË

Numri i lëndës: 2021:198242

Datë: 07.06.2024

Numri i dokumentit: 05793277

**K.DH.Shk II.nr. 807/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-** Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit “Bodrumi i Vjetër” me NUI: 810131772, me seli në Rahovec, rruga “Gëzim Hamza” p.nr, kundër debitorit “Viva Fresh” SH.P.K., me NUI: 810670390, me seli në Graçanicë, fshati Suhadoll, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.453/23 të datës 21.08.2023, me datë 07.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit “Viva Fresh” SH.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së parë, KPPP.nr. 453/23 të datës 21.08.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 453/23 të datës 21.08.2023, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimi i debitorit “Viva Fresh” SH.P.K., dhe seli Graçanicë, fshati Suhadoll, ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 157/21, i lejuar me datë 04.06.2021, nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.

157/21, i lejuar me datë 04.06.2021, nga Përmbaruesi Privat Emine Sherifi Lubeniq mbetet në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, (*me pretendime sikur në ankesë*), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuara dhe jo të plote të gjendjes faktike dhe zbatimit të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 453/23 të datës 21.08.2023,

Kreditori ka ushtruar përgjigje në ankesë me të cilën ka propozuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i shkallës së parë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Bodrumi i Vjetër”, ka paraqitur propozim për përmbarim P.nr. 157/2021, i lejuar me datë 04.06.2021, me të cilin ka lejuar përmbarimin, mbi bazën e dokumenteve të besueshme; Faturës nr.732/20 të datës 03.11.2020, Faturës nr.757/20 të datës 11.11.2020, Faturës nr.758/20 të datës 11.11.2020, Faturës nr.778/20 të datës 17.11.2020, Faturës nr.802/20 të datës 24.11.2020, Faturës nr.828/20 të datës 01.12.2020 si dhe Faturës nr.831/20 të datës 02.12.2020, me të cilin ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit t’ia paguaj kreditorit shumën prej 8,399.86 €, me kamatë vjetore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e përmbaruesit privat, si dhe me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit. Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka deklaruar se përmbaruesi privat me urdhrin për përmbarim ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike për shkak se të dy palët ndërgjyqëse kanë pasur bashkëpunim të mirë për një kohë relativisht të gjatë dhe gjithmonë kanë përmbushur detyrimet dhe përgjegjësitë që kanë pasur ndaj njëri tjetrit. Tutje

ka shtuar se debitori ka përmbushur pjesën e parë dhe pjesën e dytë të obligimit e cila vërtetohet përmes dëftesë pagesave që evidentohen në shkresat e lëndës, ashtu që debitori ka përmbushur detyrimet që ka pasur ndaj kreditorit brenda afatit ligjor. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri për përmbarim. Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara, duke theksuar se dy pagesat të cilat debitori ka çekur në prapësim nuk kanë të bëjnë me borxhin nga faturat me të cilat është inicuar procedura përmbarimore. Këto dy pagesa me përshkrimin “pagesë malli” nuk përputhen me faturat e lartcekura dhe të njëjtat kanë të bëjnë me borxhin e mëparshëm, ndërsa faturat me të cilat është lejuar përmbarimi kanë mbetur të papaguara. Më tutje ka theksuar se përmes këtyre pagesave tentohet të vihet në lajthim gjykata, ngase nuk kanë të bëjnë asgjë me faturat e bashkëngjitura në propozim. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi urdhrin e përmbaruesit privat.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë duke vendosur lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaket si në vijim: Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat, në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 dhe 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë ka vlerësuar faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor nga përmbaruesi privat, përmbaruesit privat bazohet në dokument të besueshme, përkatësisht faturën nr. 732/20 të datës 03.11.2020, Faturën nr.757/20 të datës 11.11.2020, Faturën nr.758/20 të datës 11.11.2020, Faturën nr.778/20 të datës 17.11.2020, Faturën nr.802/20 të datës 24.11.2020, Faturën nr.828/20 të datës 01.12.2020 si dhe Faturën nr.831/20 të datës 02.12.2020, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përcaktuara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, koha e përmbushjes së detyrimit, shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga vula dhe nënshkrimi i debitorit. Andaj faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në kopje të vërtetuar.

Tutje gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore nga neni 71 i LPP-së, mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe shkalla e dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Tutje dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet

ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhoma e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbartimore, respektivisht është lejuar përmbartimi i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se faturat e përmbajnë nënshkrimin e pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbartueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Së këndejmi, Gjykata thekson se me plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm mund ta ketë fuqinë e titullit përmbartues sepse rezulton se debitori e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbartimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbartimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Një veprim i tillë, për Gjykatën paraqet pranim të faturës dhe detyrimit.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbartimore organi përmbartues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbartimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbartues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbartues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale,

të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbare.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

**Dhoma e shkallës së dytë**

**K. DH.Shk II.nr. 807/24 me datë 07.06.2024**

**Gjyqtarja,  
Saranda Bogaj Sheremeti**